BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

PERCEPTIMI QYTETAR MBI LËVIZSHMËRINË DHE KORSITË E DEDIKUARA PËR BIÇIKLETA

Raporti përmbledhës i sondazhit

Maj 2020

Përmbajtja e tabelave

Faqe

Grafiku 1. Pyetësorët për secilën njësi administrative dhe lagje 5

Grafiku 2.GjiniaGrafiku 3.Grup-mosha (vjeç) 5

Grafiku 4.Gjendja civile 6

Grafiku 5.Edukimi 6

Grafiku 6. Gjendja e punësimit 6

Grafiku 7. Makina në pronësi për njësi banimi 7

Grafiku 8. A udhëtoni përgjatë javës (përveç të dielës) nga ora 06:00am – 09:00am 7

Grafiku 9. Mënyrat më të shpeshta të lëvizjes/transportit 8

Grafiku 10. Sa herë në javë udhëtoni 8

Grafiku 11. Cili është qëllimi i udhëtimit 9

Grafiku 12. Vlerësimi për nismat dhe projektet e Bashkisë se Tiranës 9

Grafiku 13. Mendoni se përdorimi i biçikletave është një alternativë e mirë lëvizshmërie 10

Grafiku 14. A janë koristë e dedikuara një rritje e sigurisë 10

Grafiku 15. Mendoni se mbështesim ekosistemin duke krijuar një kulturë çiklizmi 11

Grafiku 16. A duhet të shtojë Bashkia e Tiranës investimet për ndërtimin e korsive të reja 11

Hyrje

Tirana është një qytet që po zhvillohet gjithnjë e më shumë, një qytet inovativ , “green” dhe me më shumë korsi biçikletash. Bashkia e Tiranës i ka kushtuar një rëndësi të veçantë politikave ambientaliste, që promovojnë përdorimin e mjeteve që nuk ndotin ajrin, siç është edhe përdorimi i biçikletave.

Për këtë arsye kemi zhvilluar sondazhin mbi lëvizshmërinë, i cili është përqendruar tek ndërtimi i korsive për biçikleta dhe nxitja e përdorimit të tyre si një aternativë lëvzishmërie e cila ka një sërë ndikimesh pozitive në mjedis, shëndet, lehtësimin e trafikut, si edhe në ekonominë e përdoruesve.

Kufizimi i qarkullimit të automjeteve në Tiranë për shkak të virusit, tregoi domosdoshmërinë e lëvizjes me biçikleta e se nisma për shtimin e korsive të biçikletave dhe zgjerimin e trotuareve rezultoi se ishte e drejtë.

Nismat e Bashkisë së Tiranës për të pakësuar përdorimin e automjeteve private duke ofruar kushte optimale për përdoruesit e biçikletave, si zgjerimi i rrjetit të korsive në të gjitha rrugët kryesore dhe ato ku mund të ndërhyet, ka rezultuar në shtimin e qytetarëve përdorues. Zhvillimet dhe përmirësimet në infrastruktuë janë një mundësi për sigurinë e çiklizmit, rrugët bëhen më të sigurta, çlirohet trafiku, gjë që e bën qarkullimin më pak kaotik dhe më të sigurt për të gjithë.

Për herë të parë është vendosur një fond i posaçëm për këtë qëllim edhe në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës, ku rrugët e reja që po ndërtohen të kenë edhe një korsi të dedikuar për biçikletat. Duke kombinuar masat për të promovuar çiklizmin dhe transportin publik, qytetet mund të kenë sukses në uljen e nivelit të përdorimit të makinave.

Tirana është qyteti i parë në Ballkan ku u fut sistemi i biçikletave pa stacion. Pra, secili me celularin e vet, mund të shkarkojë aplikacionin dhe duke skanuar barkodin e biçikletës, mund ta përdorë atë kundrejt pagesës në të gjithë qytetin.

Aktivitetet e ndryshme promovuese si “Dita pa makina”, i kanë dhënë mundësinë të gjitha moshave për të pedaluar lirshëm nëpër rrugët e qytetit. “Pedalo Tiranën” një konkurs online mbi numrin më të madh të kilometrave të kryera me biçikletë do të zhvillohet në përiudhën maj - qershor 2020.

Sidoqoftë është e rëndësishme që drejtuesit e qytetit të qëndrojnë fleksibël dhe të dinë se cilat shembuj janë më të dobishëm për qytetet dhe sfidat e tyre të veçanta. Në të njëjtën kohë mbetet shumë për t’u bërë për sensibilizimin e qytetarëve që të mos e marrin makinën por biçikletën për të lëvizur.

Qëllimi dhe objektivat e sondazhit

Qëllimi: Vjelja e opinionit lidhur me perceptimin qytetar mbi lëvizshmërinë në qytet, korsitë e dedikuara dhe nxitjen e përdorimit të biçikletave, si një alternativë lëvizshmërie, e cila ndikon për një cilësi jetese më të mirë dhe të shëndetshme.

Objektivat:

- Identifikimi i densitetit të udhëtimit/eve, gjatë javës, në intervalin 06am – 09am;
- Evidentimi i mënyrave më të shpështa të lëvizjes/transportit;
- Përcaktimi i frekuencës dhe qëllimit të udhëtimit/eve gjatë javës në përgjithësi;
- Matja e vlerësimit qytetar për nismat dhe projektet e Bashkisë Tiranë lidhur me zgjerimin e rrjetit të korsive të dedikuara dhe nxitjen e përdorimit të biçikletave;
- Vjelja e mendimit qytetar nëse përdorimi i biçikletave dhe shtimi i korsive të dedikuara është një alternativë e mirë lëvizshmërie për qytetin e Tiranës;
- Ndikimi që kanë korsitë e dedikuara në rritjen e sigurisë për përdoruesit e biçikletave dhe për lëvizshmërinë në përgjithësi;
- Cili është mendimi qytetar sa i përket raportit ekosistem/qytet i shëndetshëm - kulturë çiklizmi;
- Identifikimi i nevojës për investime të mëtejshme në ndërtimin e korsive.

REZULTATET KRYESORE TË SONDAZHIT

Nëpërmjet grafikëve, ky raport pasqyron rezultatet kryesore në total të sondazhit, ku secili zë i grafikëve të mëposhtëm shënon të dhënat në total të të gjitha intervistave të kryera, gjatë procesit të vjeljes së mendimit qytetar.

Në këtë sondazh, sipas qëllimit dhe objektivave të tij, u evidentuan çështjet e mëposhtme:

Të dhëna mbi 1834 pyetësorët e plotësuar dhe demografinë e të aketuarve

Grafiku 1. Pyetësorët për secilën njësi administrative dhe lagje



Grafiku 2.Gjinia



Grafiku 3.Grup-mosha (vjeç)



Grafiku 4.Gjendja civile



Grafiku 5.Edukimi



Grafiku 6. Profesionet



Grafiku 7. Makina në pronësi për njësi banimi



Pyetjet

Për të realizuar një studim sa më të saktë dhe për të pasur rezultate të cilat mund të shërbejnë dhe të përdoren në përmirësimin e lëvizshmërisë, në orarin ndoshta më të ngarkuar me trafik, atë të mëngjesit, në vazhdim sondazhi është fokusuar vetëm tek qytetarët që lëvizin në fashën orare 06:00am – 09:00am.

Grafiku 8. A udhëtoni përgjatë javës (përveç të dielës) nga ora 06:00am – 09:00am



Të anketuar që udhëtojnë në fashën orare 06:00 – 09:00 të mëngjesit

Grafiku 9. Mënyrat më të shpeshta të lëvizjes/transportit[1]



Grafiku 10. Sa herë në javë udhëtoni



[1] *Për sa i përket shifrave dhe të dhënave në përqindje, rezultati në grafikë, i paraqitur në këtë pyetje, si shumë totale mund të mos jetë i barabartë me 100% për shkak të mundësisë për të shprehur më shumë se një alternativë brenda të njëjtës pyetje.*

Grafiku 11. Cili është qëllimi i udhëtimit[2]



Grafiku 12. Vlerësimi për nismat dhe projektet e Bashkisë se Tiranës[3] lidhur me zgjerimin e rrjetit të korsive të dedikuara dhe nxitjen e përdorimit të biçikletave



[2] *Për sa i përket shifrave dhe të dhënave në përqindje, rezultati në grafikë, i paraqitur në këtë pyetje, si shumë totale mund të mos jetë i barabartë me 100% për shkak të mundësisë për të shprehur më shumë se një alternativë brenda të njëjtës pyetje.*

[3] *Vlerësimi nga 1 – 10 (1 = aspak mirë dhe 10 = shumë mirë)*

Grafiku 13. Mendoni se përdorimi i biçikletave është një alternativë e mirë lëvizshmërie



Grafiku 14. A janë koristë e dedikuara një rritje e sigurisë



Grafiku 15. Mendoni se mbështesim ekosistemin duke krijuar një kulturë çiklizmi



Grafiku 16. A duhet të shtojë Bashkia e Tiranës investimet për ndërtimin e korsive të reja



PYETËSORI I SONDAZHIT

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësorit_____ Data_____/_____2020

PERCEPTIMI QYTETAR MBI LËVIZSHMËRINË DHE KORSITË E DEDIKUARA PËR BIÇIKLETA

I. Seksioni: Demografia

Njësia Administrative	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)				Gjendja civile		
	F	M	15-29	30-45	46-64	Mbi 65	Beqar/e	I/E martuar	I/E ve

Edukimi	Arsimi bazë	Arsim i mesëm	Arsim universitar	Pasuniversitar	
Profesioni	Student	I/E punësuar	I/E papunë	Pensionist/e	Shtëpiak/e
Makina në pronësi për njësi banimi	Asnjë	1	2	Më shumë se 2	

II. Seksioni: Pyetjet

1. **<u>Audhëtoni përgjatë javës (përveç të Dielës) nga ora 06.00 am deri në orën 09.00 am</u>?**
   (Nëse Jo, intervista ndërpritet pasi nuk është e vlefshme)

   ☐ Po ☐ Jo

2. Cilat janë mënyrat tuaja më të shpeshta të lëvizjes/transportit?

   ☐ Ecje
   ☐ Biçikletë
   ☐ Motorçikletë
   ☐ Mjet privat (drejtues)
   ☐ Mjet privat (pasagjer)
   ☐ Autobus publik
   ☐ Taksi
   ☐ Tjetër_____

3. Sa herë në javë udhëtoni?

☐ 1 herë në javë ☐ 2-3 herë në javë ☐ 4-5 herë në javë ☐ përditë

4. Cili është qëllimi i udhëtimit?

☐ Pun☐ Arsim☐ erjet ☐rgëtim ☐jetër_____

5. Nga informacioni që keni si i vlerësoni nismat dhe projektet e Bashkisë së Tiranës lidhur me zgjerimin e rrjetit të korsive të dedikuara dhe nxitjen e përdorimit të biçikletave? (*Vlerëso nga 1 në 10, ku 1 = aspak mirë dhe 10 = shumë mirë)*

Aspak mirë – 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 – Shumë mirë

6. Mendoni se përdorimi i biçikletave dhe shtimi i korsive të dedikuara është një alterantivë e mirë lëvizshmërie për qytetin e Tiranës?

☐ Po ☐Jo ☐ Pjesërisht ☐ Pa përgjigje

7. A janë korsitë e dedikuara një rritje e sigurisë për përdoruesit e biçikletave dhe lëvizshmërinë në përgjithësi?

☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht ☐ Pa përgjigje

8. Duke krijuar një kulturë çiklizmi mendoni se mbështesim ekosistemin për të patur një qytet të shëndetshëm?

☐ Po ☐ Jo ☐esërisht ☐ Pa përgjigje

9. Sipas mendimit tuaj, a duhet të shtojë Bashkia e Tiranës investimet për ndërtimin e korsive të reja?

☐ Po ☐Jo ☐Pa përgjigje

Shënim:

Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim vjeljen e opinionit lidhur me perceptimin qytetarmbilëizshmërinë, korsitë e dedikuara dhe nxitjen e përdorimit të biçikletave si një alternativë lëvizshmërie dhe për një jetë më të shëndetshme:

- Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit";

- Ligji 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik";

- Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";

- Ligji nr. Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

LITERATURA/ LEGJISLACIONI I PËRDORUR

1. Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
2. Ligjin 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
3. Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
4. Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”.
5. Ligji nr. 10/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 8308, datë 18.03.1998, Për transportet rrugore, të ndryshuar”.
6. Ligji nr. Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.